




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Zyra Kryetarit



Nr. 400-66038 dt. 02.11 /2018

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 31/10/2018

1. Vendim për ridestininim të mjeteve për shpenzime kapitale.
2. Vendimi për ndryshimin e emrit të projektit: zgjerimi i QMF-së Gllanasellë.
3. Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e RREGULLORES PËR TARIFA NGARKESA DHE GJOBA .
4. Vendimi për ridestininim të mjeteve nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të mjedisit.
5. Vendim për transferim të mjeteve.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës


12 Nr. 400-66035 dt. 02.11 2018



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 31/10/2018



1. Vendim për ridestitim të mjeteve për shpenzime kapitale.
2. Vendimi për ndryshimin e emrit të projektit: zgjerimi i QMF-së Gllanasellë.
3. Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e RREGULLORES PËR TARIFA NGARKESA DHE GJOBA .
4. Vendimi për ridestitim të mjeteve nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të mjedisit.
5. Vendim për transferim të mjeteve.



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT
Kuvendi i Komunës



Nr. 11.400-66039 Dt: 02.11 2018

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40, paragrafi 2.Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 31.10. 2018 miratoj këtë:

VENDIM
PËR RIDESTINIM TË MJETEVE PËR SHPENZIME KAPTALE

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet ridestininii mjeteve për shpenzime kapitale në programin bugjetor të Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Neni 2

Ridestিনি i mjeteve behët nga këto projekte kapitale më këto në shuma:

- Kodi i projektit I : 10/611/18001/31270/46137/0451, Rregullimi i deponisë inerte 1,912.09 €
- Kodi i projektit II : 10/611/18001/31230/46035/0451, Asfaltimi i plogonit të zjarrfikësve 296.10 €
- Kodi i projektit III : 10/611/18001/14032/0000/0451, Pastrimi I rrugëve gjatë verës 2,000.00 €

Vlera totale nga këto projekte është 4,208.19 €

Neni 3

Shuma e mjeteve për ridestininim e përmendur në neni 2 i këtij Propozim-Vendimi do të shpenzohen në këtë kategori ekonomike të shpenzimeve, konkretisht në këtë projekt

I. Shpenzimet Kapitale:

- Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë, ridestininimin e mjeteve do t'i shpenzoj në këtë projekt kapital :

- Kodi i projektit :10/611/18001/31270/46036/0451 , Rregullimi i ndriçimit publik në rrugët e qytetit të Drenasit

.....4,208.19 €


Gjithsejtë investimet kapitale në shumë prej: 4,208.19 €

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet e Financa dhe Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labir Hot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-66040 dt. 02.11 2018

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-40 , dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullore të datës 31.10.2018 miratoi këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E EMRIT TE PROJEKTIT : ZGJERIMI I QMF-SË GLLANASELLË
Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet ndryshimi emrit të projektit nga Zgjerimi i QMF Gllanasellë në :
NDERTIMI I DEPOSË PËR LËNDË DJEGËSE, FURNIZIMI ME KALLDAJË DHE
RENOVIMI I OBJEKTIT TË QMF-SË NË GLLANASELLË.

Neni 2

Shuma financiare nuk ndryshon për këtë projekt, mbetet e njëjta që është parapare për këtë vit.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohet Ministria e Financave, Zyra e Kryetarit, dhe DSHMS.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, dhe DSHMS Drenas

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja
si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
z. Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Nr 400-66041 dt. 02.11 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 neni 2 paragrafi 3, nenit 8 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/L-049, UA i MMPH nr.14/2015 dhe UA i MMPH nr.01/2017, neni 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar në vitin 2008 dhe shkresës nga MAPL nr.43-468/1 e dt:17.11.2017, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në Mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2018 Aprovoi këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e RREGULLORES PER TAKSA TARIFA NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1

Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet RREGULLORJA PER TAKSA TARIFA NGARKESA DHE GJOBA.

Neni 2

Me këtë vendim Ndryshohet dhe Plotësohet neni 12 i rregullores nr 12.030-19516 të datës 06.04.2018, i cili nen ka të bëjë me Taksat dhe Ngarkesat për lëshimin e dokumentave zyrtare, të Drejtoria e Administratës t'i shtohen shërbimet nga ueb-faqet-shërbimet nga distanca – Online.

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1.0 Lëshimi i certifikatave të statusit civil dhe dokumenteve tjera	
1.1. Ekstrakti i lindjes;	2
1.2. Certifikata e lindjes;	2
1.3. Certifikata e martesës;	2
1.4. Certifikata e vendbanimit;	2
1.5 Certifikata e shtetësisë;	2
1.6. Dokumentet tjera; Taksa e aprovuar + Shërbimet Postare	Taksa+PTK

Neni 3

Taksat e aprovuara nga Kuvendi i Komunës mbeten në fuqi, u shtohet vetëm shërbimet postare për dërgimin e shërbimet deri te kërkuesi (Qytetari).

Neni 4


Me këtë ndryshim do të njoftohet të gjitha drejtorit dhe zyret komunale në Komunën e Drenasit.

Neni 5

Per zbatimin e këtij vendimi përkuajdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
z. Labino Halilaj

A R S Y E T I M

Avancimi dhe modernizimi i shërbimeve digjitale komunale do të mundësoj avancimin e proceseve dhe shërbimeve administrative në komuna. Gjithashtu do të ndihmojnë në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të administratës në komunikimin e brendshëm dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Portalet e komunave janë pjesa publike dhe shërben për komunikim direkt në mes komunës dhe qytetarëve. Kjo është porta kryesore e komunikimit, prandaj përdorimi i platformës së re të ueb faqes, qytetareve ju ka mundësuar qe disa nga shërbimet ti marrin nga shtëpia.

Tani qytetarët duke përdorur platformën e re të ueb faqes online, mund ti marrin disa nga shërbimet e gjendjes civile.

Qytetarët me përdorimin e ueb faqes së re janë përfituesit kryesorë, pa pasur nevojë për të frekuentuar zyrat komunale.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
KOMUNA GLOGOC
KUVENDI I KOMUNËS

Nr. 12-400101-65568 dt. 01.11. /2018



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40.40.2 nën b dhe c të ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të nenit 8 të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 si dhe nenit 34.6 nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i komunës në mbledhjen të mbajtur me datën 31.10.2018, miratoi këtë

V E N D I M
PËR RIDESTINIM TË MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim,miratohet ridestnimi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor Drejtoratin për Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 2 .

Ridestnimi i mjeteve behët nga këto projekte kapitale me këto shuma:

1. Asfaltimi i rrugës në fshatin Shtuticë me kod të projektit 46107 (10) dhe shumë prej: 9,649.60 €
2. Asfaltimi i rrugës në fshatin Bytyq me kod të projektit 43019 (10) dhe shumë prej. 3,284,50 €
3. Asfaltimi i rrugës në fshatin Godancë me kod projektit 89079 (10) në shumë prej:3,020.25
- 4.Kanalizimi i ujerave të zeza në fshatin Dobroshecë me kod projekti 44761 (10) në shumë prej : 11,687.00
5. Kanalizimi i ujerave të zeza në fshatin Polluzhë me kod projekti 46994 (10) në shumë prej:4,878.00 €
6. Kanalizimi i ujerave të zeza ne fshatin Krejkovë me kod projekti 89068 (10) në shumë prej:5,255.60 €
7. Kanalizimi i ujerave të zeza në fshatin Tersteniku I me kod projekti 46118 (10) ne shumë prej: 4,417.00 €
8. Kanalizimi i ujerave të zeza në fshatin Tersteniku II me kod projekti 40020 (10) ne shumë prej: 5,077.00 €
9. Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllobar me kod projekti 40018 (10) në shumë prej:3,179.50
10. Hartimi i projekteve zbatues për nevoja të komunës me kod te projektit 40041(10) ne shumën prej 40,000,00 €
11. Mbikëqyrja i projekteve kapitale ne KIK Drenas me kod te projektit 43016(10) ne shumën prej 20,000,00 €
12. Asfaltimi i rrugës në fshatin Vasilevë me kod 89045(10) ne shumen prej 5,900.50 €
- 13 .Asfaltimi ne fshatin Gllanasell me kod te projektit 40028(10) 5,687.50 €
14. Asfaltimi ne fshatin Krejkovë me kod te projektit 46097(21) 4,170.00 €

Ridestnimi në shumë prej : 126,206.45 €


Neni 3.

Ridestnimi i mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi ridestinohe në këto projektet kapitale:

1. Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat me kod projektit 46105 (10) në shumë prej: 12,934.10 €
2. Asfaltimi në fshatin Dobroshec me kod projekti 44745 (10) dhe shumë. 14,707.25 €
3. Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Baicë me kod të projektit 89039 (21) në shumë prej: 19,627.60
4. Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë me kod projekti 46098 (10) ne shumë prej 3,179.50 €
5. Asfaltimi i rrugës në fshatin Korrotic e Ulet me kod projekti 40029 (21) ne shumë prej 30,000.00 €
6. Ndërtimi i trotuarit Krejkovë Drenas me kod projekti (21) ne shumë prej 20,000.00 €
7. Rregullimi i trotuarit fshatin Damanek me kod projekti 46131 (21) ne shumë prej 10,000.00 €
8. Asfaltimi i rrugës në fshatin Terrdefe me kod te projektit 44753(10) ne shumen prej 5,900.50 €
9. Hapja e kanaleve ne rrugët ekzistuese me kod te projektit 46133(10) ne shumen prej 9,857.5€

Neni4.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjit nr. 03/L-040 si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
KOMUNA GLLOGOC
KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 12-400/01-65469 dt. 31.10.2018



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40.40.2 nën b dhe c të ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të nenit 8 të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 si dhe nenit 34.6 nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i komunës në mbledhjen të mbajtur me datën 31.10.2018, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR TRANSFERIM TË MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim të miratohet Transferi i mjeteve për shpenzime kapitale nga programi buxhetor Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport në Drejtoratin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit.

Neni 2 .

Transferi i mjeteve behët nga ky projekt kapital me këtë shumë :

1. Ndërtimi i një qendre Rinore me kod të projektit **(44718 (10))** në shumë prej: **61,712.31 €**

Transferi në shumë prej : 61,712.31 €

Neni 3.

Transferi i mjeteve nga neni 1 i këtij propozim vendimi Transferohet në këtë projekt kapitale:

1. Bashkëfinancim i projekteve me kod projekti **46126 (10)** dhe në shumë prej : **61,712.31 €**

Neni 4.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimin të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
z. Labiriot Halilaj